

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE
MJEDIS
TE AKTIVITETIT

“Linje per prodhimin e lengjeve te frutave (Amita)”



Subjekti: “Partner Ballkanik” sh.p.k

Vendndodhja: Libohove, Gjirokaster

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2018

PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktojne probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Linje per prodhimin e lengjeve te frutave (Amita)”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt*

te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti “ **Partner Ballkanik** ” sh.p.k eshte regjistruar prane QKR me numer NIPT-i **K43128613A** me administrator **Z. Christos Kouros** me adrese te selise qendrore ne Gjirokaster Libohove,kryqezimi i rruges ”Libohove-Nepravisht”,km 3,nr.pasurie 1151/1,zona kadastrale 24444 .Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore tipi B .

Qellimi i projektit

Qellimi i projektit eshte prodhimi i lengjeve te frutave (Amita).

Vendndodhja

Subjekti” **Partner Ballkanik**” shpk do e ushtroje aktivitetin e tij ne Libohove, Gjirokaster .



Pamje te vendit te ushtrimit te aktivitetit



Projekte te tjera qe do ti vijne ne ndihme aktivitetit


Per zhvillimin e aktivitetit nuk do te kete projekte te tjera sepse sistemi rrugor ekziston, dhe objekti ndodhet buze rruges. Per mbarevajtjen e aktivitetit kjo rruge do te mirembahet nga personeli i shoqerise. Eshte lidhur kontrata me rretin e shperndarjes se energjise elektrike. Ne rast mungese energjia elektrike do sigurohet permes nje gjeneratori.

Pershkrimi i impjantit dhe proceset qe ndodhen ne te

Pershkrimi i subjektit dhe aktivitetit "Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkolike"

- Reparti i prodhimit te pijeve perbehet nga:

1. Linja e trajtimit dhe pastrimit te ujit.
 2. Linja e prodhimit te shirupit per produktet.
 3. Linja e mbushjes dhe e ambalazhimit te produkteve.
- 1- Ne linjen e trajtimit dhe te pasurimit te ujit behet e mundur qe ne dalje nga impianti, uji te kete karakteristikat qe pershkruben ne standartin Shqipetar per ujerat qe perdoren ne industrine ushqimore. Kjo linje trajton ujin duke kaluar ne disa procese.



- a- Uji që përdoret në procesin teknologjik merret me anë të pompave zhytëse të cilat bëjnë mbushjen e 4 cisternave me kapacitet max 100 m³ secila. Në hyrje të cisternave është montuar një pompe dozuese e cila injekton klorë për të bërë eliminimin e ngarkesës bakteriale që mund të ketë uji.
- b- Me pasë uji kalon në filtrin e rres për eliminimin e lëndëve pezull, pastaj nëpër 2 filtrat e karbonit aktiv ku përveç largimit të lëndëve pezull të ngelura, lëndëve organike arrihet dhe eliminimi i klorit me anën e karbonit aktive që këto filtra përmbajnë. Me pasë uji kalon në sistemin e osmoses e cila është pajisur me një membranë gjysem të përshkueshme dhe ku bëhet e mundur largimi kriperave të ujit pra shkripezimi i tij, e me pasë uji kalon në llampën ultraviolettë ku realizohet pastrimi total i ujit nga ngarkesa bakteriale dhe së fundmi depozitohen në serbatorin me kapacitet 10 m³ dhe është i gatshëm për tu përdorur në përgatitjen e shirupit të thjeshtë dhe në linjën e mbushjes së pijeve.



Linja e mbushjes dhe e ambalazhimit është e një prodhimi cilësor. Kjo linjë moderne ka të gjitha parametrat Europiane që duhet të ketë produkti që mbushet dhe ambalazhohet.

PERSHKRIMI I MJEDISIT TE RAJONIT

Pershkrimi i pergjithshem per Qarkun Gjirokaster

Qarku i Gjirokastrës ka nën administrimin e tij 3 rrethe që janë : 1. Rrethi Gjirokaster 2. Rrethi Permet 3. Rrethi Tepelene

Kushtet fizike të zonës Tokat:

kategoria e tokës, gjeologjia dhe morfologjia Siperfaqja është e rrafshet. Ka kushte të mira për ndërtimin e objekteve. Këto depozitime nuk përfaqësojnë toka produktive.

Objekti i kërkuar ndodhet në pjesën jugore të Shqipërisë me klimë mesdhetare. Dimri përgjithësisht është i butë dhe me lagështirë, ndërsa vera është e nxehtë dhe e thatë. Në zonë ka më shumë 2000 orë ndricim me diell, Korriku 360 orë dhe Dhjetori 110 orë. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 13.6°C, mesatarja e janarit 5.7 °C. Dhe e muajt më të ngrohtë 22.11 °C, në Gusht temperatura shkon 38 °C, ndërsa në Janar zbret rralle në -1 °C. Vlera mesatare e reshjeve shkon rreth 1280 mm/vit. Në periudhën Tetor- Maj, bien rreth 75% e reshjeve. Sasia maksimale e reshjeve është regjistruar gati 80mm shi në 24 orë. Lagështia e ajrit rezulton sipas stinëve nga 65% -80%. Drejtimi i erërave është kryesisht nga veri-lindja në drejtim të jug-perëndimit që favorizohen nga disnivelet e relievit dhe lugina e Drinosit Trashgimia arkitektonike dhe historike Lidhja e objektit me rruget ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura. Në këtë zonë nuk ka objekte arkitektonike dhe interesa historike. “Prodhim i Eksplozivëve” Pranë fshatit Kakavije, Komuna Dropull i Sipërm, Rrethi Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë.

Rrjeti hidrografik natyror i zonës

Shqipëria ka një rrjet të dendur hidrografik që përbëjnë një burim të madh në Shqipëri. Siperfaqja ujëmbledhëse vlerësohet rreth 43.305 km², nga të cilët 28.550 km² janë brenda kufirit shtetëror. Rrjeti hidrografik përbëhet nga 11 lumenj kryesorë, që bashkë me degët dhe përrenjtë e mëdhenj arrijnë në 152. Gjithashtu ka 4 liqene të mëdha dhe një numër i madh liqenesh të vogla, që zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.032 km². Shqipëria është e pasur me burime nëntokësore, ku llogariten rreth 200 burime me prurje të përafërt prej 200 l/sek secili. Ujërat sipërfaqësore janë gjithashtu një përbërës i peizazhit natyror të Shqipërisë dhe ekosistemet e lidhura me to janë të karakterizuara nga një biodiversitet i pasur. lumenjtë në vendin tonë në përgjithësi kanë një cilësi të mirë. Stacionet monitorues e kanë bërë përzgjedhjen në mënyrë të tillë që mostrat e analizuar të merren larg burimeve të ndotjes, në mënyrë që të vlerësohet cilësia mesatare dhe aftësia tretëse e mjedisit pritës. Treguesit më të zakonshëm për vlerësimin e cilësisë së ujit të lumenjve janë perberësit organikë, nutrientet, nitrogjeni inorganik, si dhe përbërja e substancave mikrondotese. Treguesit mjedisore të matur për monitorimin e cilësisë së ujërave të lumenjve dhe përrenjve janë : Lënda inorganike, lënda në suspension, oksigjeni i tretur, nevojat kimike për oksigjen, format e ndryshme të azotit, fosfori total si edhe radioaktiviteti beta – total . Nga të dhënat e monitorimit të lumenjve rezulton se lumenjtë e vendit tonë janë të një cilësie të mirë. Ndotja e tyre është

kryesisht e natyrës organike për shkak të shkarkimeve të lëngëta urbane që derdhen në ta. Lumenjtë më të ndotur vazhdojnë të mbeten lumi i Gjanices dhe lumi Ishëm. Në lumenjtë Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Seman përmbajtja e O₂ të tretur është nën vlerën 100%. Kjo në disa raste ndodh si rezultat i ndotjes nga shkarkimet e renda urbane, ndërsa në disa të tjera nga shkarkimet komunale-industriale. Vlerat e radioaktivitetit në lumenjtë luhet në kufi relativisht të gjere, nga disa dhjetëra deri në rreth 200mBq/l. Rezultatet e përfuara flasin për nivele normale të radioaktivitetit natyror i cili për ujërat e lumenjve luhet në vlerat 70-135mBq/l. Lumenjtë shqiptarë dallohen për vëllimin e tyre të madh. Rrjedha e përgjithshme mesatare vjetore është rreth 1.308 m³/sek, ndërsa rrjedhat e ngurta janë shumë më të mëdha. Rrjedha mesatare në vite arrin në një vëllim të përgjithshëm prej 53.250.000 ton material aluvial ose 1.650 kg/sek. Rrjedha e ngurtë gjatë periudhës së lagësht të vitit është 82% e vëllimit vjetor. Gjatë 1997-1998, janë kryer një sërë analizash në ujërat e lumenjve të vendit, rezultatet e të cilave tregojnë se ujërat e lumenjve kanë pH lehtësisht bazik, që lëviz nga 7,5 në 8,25, ndërsa mineralizimi i tyre shkon nga 200-400 mg/l. Pellgu më i afërt pranë zonës së projektit është ai i lumit Drino.

Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit-Shkarkimet e gazeve acide në atmosferë kanë një ndikim negativ mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, të cilat janë të ndjeshme ndaj aciditetit si edhe ndaj cilësisë dhe përbërjes kimike të tokës. Gjithashtu, kjo dukuri shkakton dëmtime në trashëgiminë kulturore sepse pakëson gradualisht cilësinë dhe fortësinë e monumenteve kulturore, ndërtesave prej mermeri etj. Për më tepër, çlirimi i përbërësve të azotit në atmosferë, shkakton atrofizimin në ekosistemet tokësore dhe detare.

2. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

Ndikimet fizike të projektit, si psh ndryshimi në topografine lokale, erozioni i tokës, etj.

Rruget që të çojnë në fabrike janë të asfaltuara, përpara fabrikes është ndërtuar një lulishte dhe përreth janë mbjelle pemë dhe lule dekorative. Për mirëmbajtjen e tyre tregohet një kujdes i veçantë dhe i perhershëm nga personeli i fabrikes.

Ndikimet në popullsi

Ndikimet në popullsi si rezultat i zhvillimit të këtij aktiviteti do të jenë pozitive pasi në këto fabrike do të punesohen banorë të zonës përreth.

Ndikimet ne ajer

Shkarkimet ne ajer qe gjenerohen nga linja teknologjike jane te filtruara nga filtrat e oxhakut dhe dalin ne lartesi mbi nivelin e nderteses. Nje kujdes i vecante tregohet ne mbajtjen nen kontroll te kaldajave, sistemit te aspirimit si dhe filtrave te oxhakut, te cilet nderrohen periodikisht.

Ndikimet ne uje

Perpara se te futet ne procesin teknologjik, uji i nenshtrohet analizave fizike, kimike dhe biologjike, ne laboratorin e fabrikes. Shkarkimet e ujerave te larjes, ujerave teknologjike si dhe ujerave te zeza jane te sistemuara nepermjet kanalizimeve, pusetave dhe derdhen ne tubacionin kryesor, por para shkarkimit ne kete mjedis ujqor prites keto ujera trajtohen dhe neutralizohen ne menyre qe te mos permbajne komponent ndotes nga impianti i trajtimit te ujrave te ngritur ne ambientet brenda kesaj fabrike.

Mbetjet te ngurta

Mbetjet qe dalin nga procesi teknologjik seleksionohen sipas llojit te materialit me pas depozitohen ne vende te caktuara brenda territorit te sheshit te fabrikes dhe shoqeria ka pajtuar nje mjet transporti per largimin e perditshem te tyre ne vendin e caktuar nga Pushteti Lokal.

Mbrojtja nga zjarri

Nga ana e shoqerise jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e fabrikes jane vendosur ne vende te dukshme pajisje te mbrojtjes nga zjarri dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

3. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

➤ Masat e marra per zvogelimin e impaktit ne mjedis

• Territori perreth fabrikes

Rruget qe te çojne ne fabrike jane te asfaltuara, perpara fabrikes eshte ndertuar nje lulishte dhe perreth jane mbjelle peme dhe lule dekorative. Per mirembajtjen e tyre tregohet nje kujdes i vecante dhe i perhershem nga personeli i fabrikes.

▪ **Shkarkime ne ajer**

Shkarkimet ne ajer qe gjenerohen nga linja teknologjike jane te filtruara nga filtrat e oxhakat dhe dalin ne lartesi mbi nivelin e nderteses. Nje kujdes i vecante tregohet ne mbajtjen nen kontroll te kaldajave, sistemit te aspirimit si dhe filtrave te oxhakat, te cilet nderrohen periodikisht.

• **Shkarkimet ne uje**

Perpara se te futet ne procesin teknologjik, uji i nenshtrohet analizave fizike, kimike dhe biologjike, ne laboratorin e fabrikes. Shkarkimet e ujerave te larjes, ujerave teknologjike si dhe ujerave te zeza jane te sistemuara nepermjet kanalizimeve, pusetave dhe derdhen ne tubacionin kryesor, por para shkarkimit ne kete mjedis ujqor prites keto ujera trajtohen dhe neutralizohen ne menyre qe te mos permbajne komponent ndotes nga impianti i trajtimit te ujrave te ngritur ne ambientet brenda kesaj fabrike.

▪ **Trajtimi i mbeturinave te ngurta**

Mbetjet qe dalin nga procesi teknologjik seleksionohen sipas llojit te materialit me pas depozitohen ne vende te caktuara brenda territorit te sheshit te fabrikes dhe shoqeria ka pajtuar nje mjet transporti per largimin e perditshem te tyre ne vendin e caktuar nga Pushteti Lokal.

▪ **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e shoqerise jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e fabrikes jane vendosur ne vende te dukshme pajisje te mbrojtjes nga zjarri dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Perdorimi i ujit eshte minimizuar.
- Depozitat e mbetjeve jane te sigurta nga rrjedhjet.
- Kontrollohen vazhdimisht gjendjet teknike te mjeteve te punes per te evituar e parandaluar, rrjedhjet e lubrifikanteve.
- Sherbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmese behet ne vende te tilla qe evitojne e kontrollojne ndotjen ne mjedis.
- Jane marre masa per parandalimin e renies se zjarrit.
- Kryhet vazhdimisht trajnimi i punonjesve per sigurimin teknik.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI

